

**VENDIM**  
**Nr. 187, datë 20.8.2018**

**MBI REFUZIMIN PËR LICENCIM TË SHOQËRISË “OBERALD ENERGJITIK” SHPK,  
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et  
“KRYEZI 3”, ME FUQI TË INSTALUAR 122.2 kw, “KRYEZI 4”, ME FUQI TË  
INSTALUAR 310.7 kw DHE “KRYEZI 5”, ME FUQI TË INSTALUAR 886.5 kw, ME FUQI  
TOTALE 1320 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 41, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 13 dhe 14, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për refuzimin për licencim të shoqërisë “Oberald Energjitik” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Kryezi 3”, “Kryezi 4” dhe “Kryezi 5”, me fuqi totale 1320 kw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 154, datë 3.7.2018, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Oberald Energjitik” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë nga HEC-et “Kryezi 3”, me fuqi të instaluar 122.2 kw, “Kryezi 4”, me fuqi të instaluar 310.7 kw dhe “Kryezi 5”, me fuqi të instaluar 886.5 kw, me fuqi totale 1320 kw.

- Me shkresën nr. 55/47 prot., datë 3.7.2018 është bërë njoftimi në media, si dhe me shkresën nr. 422/1 prot., datë 5.7.2018, i është dërguar subjektit “Oberald Energjitik” sh.p.k., kërkesa për plotësimin e dokumentacionit të munguar në dosjen e aplikimit.

- Nga shqyrtimi përfundimtar i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “Oberald Energjitik” sh.p.k., rezulton të mos jenë plotësuar kërkesat e parashikuara në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “F” (Marrëveshje koncesioni ose autorizimi nga KM-ja në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës). Subjekti ka paraqitur në ERE kontratën koncesionare nr. 10333 rep. dhe nr. 3327 kol., datë 9.9.2013. Me shkresën nr. 85/22 prot, datë 9.6.2015, me anë të së cilës MIE miraton projektin e zbatimit të HEC-ve “Kryezi 3”, “Kryezi 4” dhe “Kryezi 5”, Autoriteti Kontraktues shpreh gatishmërinë për nënshkrimin e kontratës shtesë të Koncesionit ku do të pasqyrohen ndryshimet e parametrave hidroenergjetik në përputhje me projektin e zbatimit. Subjekti ka përcjellë në ERE kërkesat që i ka drejtuar MIE-s për këtë çështje, por jo një kontratë shtesë, duke mos plotësuar kërkesën e Rregullores sipërcituar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Subjekti ka depozituar në ERE një deklaratë se shoqëria “Oberald Energjitik”, shoqëria “Bekimi Energjitik” dhe shoqëria “Eraldi Energjitik” marrin përsipër të financojnë HEC-et “Kryezi 3”, “Kryezi 4” dhe “Kryezi 5”, deklaratë e cila nuk shoqërohet nga asnjë dokument që vërteton mbështetje financiare duke mos plotësuar kërkesën e Rregullores sipërcituar;

- neni 9, pika 4.1.5, germa “b” (leje nga institucione të tjera). Subjekti ka paraqitur në aplikimin e tij vendimin nr. 1, datë 2.2.2010, të Këshillit të Basentit Ujor Mat, “Dhënie mendimi për përdorim të rezervës ujore për energji elektrike Oberald Energjitik sh.p.k”. Ky dokument nuk konsiderohet si miratim i lejes së përdorimit të ujit, duke mos plotësuar kërkesën e Rregullores sipërcituar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Refuzimin për licencim të shoqërisë “Oberald Energjitik” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Kryezi 3”, “Kryezi 4” dhe “Kryezi 5”, me fuqi totale 1320 kw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**